



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MIMOZA SADUSHAJ**  
**ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1**  
**Tirane**  
**TEL: 0692097547**

# **REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE**

**Nr. repertori: 1711**

**Nr. koleksioni: 877**

**Tirane më 19/05/2022**

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Akti noterial përbëhet nga 10 fletë



A2022053540105080519



A2022053540105080519

**AKT THEMELIMI DHE STATUT  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“NOBIS Wellness Center”**



Ne baze e ne zbatim te ligjit:

Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” me poshte referohet si “Ligji Per Shoqerite”;

- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;

- Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”

**Veprimtaria e shoqerise NOBIS Wellness Center sh.p.k.**

**do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejten dokument me Aktin e Themelimit.**

Sot, më datë 19/05/2022 (dymije e njezet e dy) , perpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqiten personalisht:

**PJESA E PARE  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1  
Ortaket**

1.1 Ortaket e shoqerise jane :

1. **Mikaela Naçi**, e bija e Kristo, shtetase Shqiptare, e lindur me 08/11/1999 ne Greqi, e indetifikuar me Leternjoftim me numer 032998703 dhe numer personal J96108028N, madhore dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.
2. **Alexis Gregoire Marie Hermans**, shtetas i Shteteve te Bashkuara te Amerikes, lindur ne New York U.S.A., me 30/01/1993, i identifikuar me Pasaporte Amerikane me Nr: 677049654 leshuar me 28/09/2021, i pajisur me Leje Qendrimi nga autoritetet shqiptare me nr. 838043866 dhe numer personal J33130002D, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

**Neni 2  
Emri**

Emri i shoqërisë është **NOBIS Wellness Center** (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3  
Selia e Shoqerise**

- 3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Shqiperi, Tiranë, Rruga Sami Frasheri, Kompleksi i pallateve “Nobis” prane Liqenit te Tiranës, Njësi Shërbimi me Nr.pasurie 7/630-N1 dhe 7/630-N21.

Adrese elektronike: mikaelanatsi@gmail.com  
Telefon: +355689002035

- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe atij te huaj ne fuqi.



A2022053540105080519



#### Neni 4 Forma ligjore

Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**.

#### Neni 5 Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pacaktuar (pakufizuar).

#### Neni 6 Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **NOBIS Wellness Center**, konsiston në:

*Pishina, palestra, dhe veprimtari në fushën e estetikës, dermo-kozmetikës, trajtimin e lëkurës dhe trupit, masazheri dhe mirëmbajtje trupore. Bar-restorant. Sherbim parkimi. Dhenie me qira e pasurive të veta apo të mara me qira. Shoqëria mund të ushtroje edhe aktivitete të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi të cilat mund të ndihmojnë në ushtrimin e aktiviteteve kryesore.*

### PJESA II KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT

#### Neni 7 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Leke i marre përsiper dhe i nënshkruar nga ortakët e saj.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota nga 5.000 leke/kuote, të cilat zotërohen nga ortakët si më poshtë :

Ortaku	Kuotat e Nënshkruara	Vlera në Leke	Perqindja(%)
Mikaela Naçi	1	5.000	50%
Alexis Gregoire Marie Hermans	1	5.000	50%
<b>Total</b>	<b>2</b>	<b>10,000</b>	<b>100%</b>

Kapitali themeltar është vetëm në monedhën vendase, në lekë.



A2022053540105060519

Kapitali i nenshkuar do te derdhet ne llogarite bankare te shoqerise nga ortaket jo me vone se 60 dite nga themelimi i shoqerise dhe jo me vone se 50 dite nga regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar.

### **III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT/ORTAKEVE**

#### **Neni 8**

#### **Përgjegjësia e kufizuar**

8.1. Ortaket jane përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

#### **Neni 9**

#### **Të drejtat e lidhura me cdo kuotë**

9.1. Cdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve ne perpjestim me % qe ka kuota e tij ne raport me kapitalin dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

#### **Neni 10**

#### **Fitimi dhe kalimi i kuotave**

- 10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:
- kontibutin ne kapitalin e shoqerise;
  - shitblerjes;
  - trashegimise
  - dhurimit
  - cdo menyre tjeter parashikuar me ligj.
- 10.2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata do behet me shkrim.

#### **Neni 11**

#### **Detyrimet e Ortakëve**

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen-njoftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.



**PJESA IV**  
**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

**Neni 12**  
**Të drejtat e asamblesë së përgjithshme**

- 12.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët zotërues të kuotave.
- 12.3 Vetëm asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesëmarrësve ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
  - (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit jashtë vendit;
  - (g) pjesëtimin dhe anulimin e kuotave;
  - (h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - (i) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
  - (j) blerjen, shitjen dhe dhënie peng të pasurive të paluajtshme;
  - (k) të vendosë për investimet;
  - (l) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
  - (m) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
  - (n) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
  - (o) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose çdo pagesë mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
  - (p) emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve, ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - (q) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - (r) përcaktimin e shpërblimeve për likuiduesit, ekspertët kontabël;
  - (s) mbikqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
  - (t) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjen e asamblese;
  - (u) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
  - (v) përcaktimin e buxhetit vjetor;
  - (w) miratimin e çdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
  - (x) Marrjen e huave në emer të shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huave
  - (aa) Lidhjen e marrëveshjeve për dhënie huave



A2022053540105060519

- 12.4 Asambleja e pergjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

### Neni 13

#### Vendimet e asamblesë së pergjithshme

- 13.1 Vendimet e renditura përpara i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave të ortakëve pjesëmarrës.

### Neni 14

#### Thirrja e asamblesë së pergjithshme

- 14.1 Asambleja e pergjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne cdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave në asamblenë e pergjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e pergjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posacme të rendit të ditës. Pas marrjes së kërkeses, jo më vonë se 15 dite, administratori është i detyruar të njoftojë thirrjen e asamblese.
- 14.3 Asambleja e pergjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, email, telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së pergjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

### Neni 15

#### Vendimet e marra në asamblenë e pergjithshme

- 15.1 Vendimet në asamblenë e pergjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Vendimet në asamblesë e pergjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm



A2022053540105080519

nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.

- 15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asambleshë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilët do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.
- 15.5 Nëse edhe pas thirrjes sipas pikes 15.4 te Nenit 15 nuk harriet pjesëmarrja sipas pikes 15.1 te ketij Neni, atëherë asambleja do të thirret përsëri, në përputhje me piken 15.4 te Nenin 15. Ne kete rast, vendimet do te miratohen me shumice te thjeshte apo te kualifikuar(sipas objektit te ceshtjes) te pjesemarrësve ne asamble.
- 15.6 Ortaket kane te drejte te perfaqesohen dhe te perfaqesojne ne asamblene e përgjithshme nepermjet prokurave te posacme te cilat duhet te depozitohen ne sekretarine e shoqerise 48 ore perpara dates se mbajteses se mledhjes.

#### **Neni 16**

##### **Drejtimi i mbledhjes se asamblese se përgjithshme**

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese se përgjithshme do të caktohet nga ortaket.
- 16.2 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

#### **Neni 17**

##### **Procesverbali i mbledhjes së asamblese se përgjithshme**

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.



A2022053540105080519

- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.



## PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### Neni 18 Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojnë Shoqërinë se bashku ose vec e vec. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione dhe/apo ceshtje të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë ne bankat e nivelit te dyte, si dhe marrjen e kredencialeve dhe per perdorimin e sherbimeve on-line si e-banking dhe te tjera me te njejta te drejta - detyrime dhe kufizime sikur keto sherbime do te kryeshin ne sportelet fizike te bankave.
  - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
  - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
  - (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrien e paradhënies;
  - (f) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
  - (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
  - (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;





A2022053540105080519

- (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- (p) ndryshimin e te dhenave të kontaktit të shoqërisë;
- (q) hapjen dhe mbylljen e selive të adresave sekondare të ushtrimit të aktivitetit brenda territorit të Shqipërisë.
- (r) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.
- (s) Administratorët, secili veç e veç, ose së bashku, kanë të drejtë dhe kompetencë të autorizojnë punonjësit e shoqërisë dhe/apo punonjës të palë të treta të personave juridike apo fizike që t'i përfaqësojnë ata dhe shoqërinë në transaksione ekonomike-financiare-juridike për të cilat nuk ka kufizim në Statut, në legjislacionin Tregëtar dhe atë Civil.

18.6. Personat e identifikuar si më poshtë do të caktohet administratorë të shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjetore me të drejtë ripërtëritjeje:

1. Znj. **Mikaela Naçi**, e bija e Kristo, shtetase Shqiptare, e lindur me 08/11/1999 në Greqi, e identifikuar me Leternjoftim me numer 032998703 dhe numer personal J96108028N, madhore dhe me zotesi juridike të plote për të vepruar.
2. Z. **Alexis Gregoire Marie Hermans**, shtetas i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lindur në New York U.S.A., me 30/01/1993, i identifikuar me Pasaportë Amerikane me Nr: 677049654 leshuar me 28/09/2021, i pajisur me Leje Qendrimi nga autoritetet shqiptare me nr. 838043866 dhe numer personal J33130002D, madhor dhe me zotesi juridike të plote për të vepruar.

**Te cilet kanë të drejtë të veprojnë të dy së bashku ose veç e veç.**

## PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET



A2022053540105083519



### **Neni 19**

#### **Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**

- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit të vitit të regjistrimit.
- 19.2 Në fund të cdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve për miratim, së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm (nese eshte e detyrueshme nga legjislacioni apo kerkuar nga asambleja).

### **Neni 20**

#### **Fitimi i Shoqërie**

- 20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahe në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 20.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Hartimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë dhe dorezimi i tyre pranë autoriteteve shtetërore do të behet sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, gjegjëslacionit fiskal dhe atij tregëtar.

### **PJESA VII**

#### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

### **Neni 21**

#### **Prishja dhe likuidimi**

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
  - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
  - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.



A2022053540105080519

22.3. Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (kater) kopje origjinale, ne Tiranë me 19 Maj 2022, ne gjuhen shqipe ne prani te perkthyeses Linda Basha.

ORTAKET E SHOQERISE  
NOBIS Wellness Center shpk

Mikaela Dagi

Alexis Hermans

~~Mikaela Dagi~~

Alexis Hermans

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ

Perkthyesja Linda Basha

